



FTESE PER OFERTE

Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë është organizatë joqeveritare e përkujdesjes sociale e dedikuar për përkrahjen e fëmijëve të braktisur dhe në nevojë, pa marrë parasysh etninë, kombësinë dhe besimin fetar.

SOS Fshatrat e Fëmijëve janë të interesuar për një sallë dhe akomodim për të zhvilluar punëtorinë tre ditore për kontekstualizimin e PRIDE me një grup punues me përfaqësues **25 pjesëmarrës**.

Punëtorinë mendohet të organizohet me datat: 28, 29 dhe 30 Shtator 2022 (tri ditë, dy netë) në komunën e Prizrenit ose rrethinë

Me këtë rast ju bëjmë Ftesë për Ofertë në përputhje me specifikat e cekura më poshtë:

- **Me datë 28.09.2022** të përfshihet: Salla për punëtorin, kafe dhe ujë gjatë pauzave, drekë me një pije joalkoolike, darkë me një pije joalkoolike dhe fjetja.
- **Me datë 29.09.2022** të përfshihet: Mëngjesi, Salla për punëtorin, kafe dhe ujë gjatë pauzave, drekë me një pije joalkoolike, darkë me një pije joalkoolike dhe fjetja.
- **Me datë 30.09.2022** të përfshihet: Mëngjesi, Salla për punëtorin, kafe dhe ujë gjatë pauzave dhe drekë me një pije joalkoolike.

- Akomodimi në dhoma teke

- Hoteli të posedojë sallë me hapësirë të mjaftueshme për punë dhe aktivitete për pjesëmarrësit
- Salla duhet të jetë e përshtatshme, të ketë hapësirë për vendosjen e pajisjeve dhe kushte për punë: të jetë e klimatizuar, të ketë projektor, lidhje stabile interneti, mundësi printimi, tabelë flipchart
- Salla të ketë kushte për punë sa l përket ndriqimit, pastërtisë dhe qetësisë
- Ofertuesi duhet të ofrojë: Akomodimin me mëngjes, Sallën për punëtorin, drekën me një pije joalkoolike, 2 kafe gjatë pauzave dhe 2 shishe ujë për person gjatë punëtorisë, darkën me një pije joalkoolike.
- Oferta duhet të jetë e specifikuar me çmime pa TVSH të ndara për njësi:

-Akomodimi me mëngjes (dhome teke) për person për një natë,

- çmimi për sallë për një ditë,
- çmimi i drekës me një pije joalkoolike për person,
- çmimi i darkës me një pije joalkoolike për person,
- çmimi për 1 kafe dhe
- çmimi për një shishe të vogël ujë



SOS FSHATRAT
E FËMIJËVE
KOSOVË

Në pajtueshmëri me Udhëzimet nga institucionet shëndetësore për luftimin e COVID-19, salla duhet të ketë distancë të mjaftueshme në mes pjesëmarrësve;

Ofertuesi duhet t'i respektojë masat kundër COVID-19, duke dezinfektuar, sallën, dhomat dhe hapësirën e ngrënjes;

Ofertuesit së bashku me ofertën duhet të dorëzojë:

1. Çertifikatën e regjistrimit të biznesit/ NUI
2. Çmimet për njësi duhet të kuotohen në euro pa TVSH
3. Oferta duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur /apo me logo zyrtare

Kriteret për përzgjedhje:

- Përbushja e specifikacionit sipas kërkesës sonë;
- Pas plotësimit të kriterëve të lartpërmendura , çmimi më i lirë

Ofertuesi i përzgjedhur para nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë Vërtetimin Tatimor

Shënim: Në rast të ndryshimit të situatës epidemiologjike me virusin COVID-19, dhe udhëzimeve nga institucionet shëndetësore për mbyllje ose anulim të aktiviteteve, organizata SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë nuk merr përgjegjësi për anulimin e aktiviteteve ose kompensimin e çfarëdolloji.

Ofertat tuaja mund t'i dërgoni deri me datën: 01.08.2022 email adresën:
procurement1@soskosova.org . Oferta juaj duhet të jetë e vlefshme 30 ditë